

**KËRKESË**  
**Nr. 958, datë 6.11.2025**

**PËR SHPREHJE INTERESI PËR SHËRBIMIN E KONSULENCËS “PËRZGJEDHJA  
E MENAXHERIT TË INVESTIMEVE PËR EMP-në”**

**SHËRBIME KONSULENCE – KONSULENCA INDIVIDUALE**

Emri i Projektit: **Mjedis i pastër dhe me aftësi ripërtëritëse për detin blu (Care4BlueSea)**  
Nr. i Huas: **95070-AL**  
Nr. i ID-së së Projektit: **P176163**  
Titulli i detyrës: **Përzgjedhja e Menaxherit të Investimeve për EMP-në**  
Nr. reference: **AL-MTE-520636-CS-INDV**

Qeveria e Shqipërisë ka marrë financim nga Banka Botërore për Projektin “Mjedis i pastër dhe me aftësi ripërtëritëse për detin blu” dhe synon të aplikojë/përdorë një pjesë të financimit për shërbime konsulence.

Shërbimet e konsulencës (“Shërbimet”) përfshijnë përzgjedhjen e një menaxheri të investimeve për EMP-në pranë Ministrisë së Mjedisit (MM). Menaxheri i investimeve i Ekipit të Menaxhimit të Projektit (EMP) do të mbështesë MM-në/EMP-në në planifikimin, koordinimin, zbatimin dhe monitorimin e përgjithshëm të të gjitha investimeve të bazuara në performancë të financuara nën komponentin 1, përfshirë krijimin dhe vënien në funksionim të Programit të Investimeve për Performancën Mjedisore (EPBI) në Zonën e Mbetjeve Vlora Jug–Gjirokastrë. Ai/ajo do të punojë si pjesë e EMP-së, do t’i raportojë dhe do të punojë nën drejtimin e koordinatorit të EMP-së, në bashkëpunim me bashkitë pjesëmarrëse dhe palët e tjera përkatëse të interesuara, me qëllim që cikli i EPBI-së, alokimi i fondeve dhe investimet përkatëse të përgatiten, zbatohen dhe dokumentohen në kohë dhe në përputhje të plotë me dokumentin e vlerësimit të Projektit marrëveshjen e huadhënies, manualin operacional të Projektit, manualin EPBI, kërkesat e Bankës Botërore dhe legjislacionin kombëtar në fuqi. Menaxheri i investimeve do të veprojë si pikë kryesore kontakti për bashkitë për të gjitha çështjet operationale dhe të investimeve të lidhura me EPBI-në, do të koordinojë proceset e mbledhjes dhe të verifikimit të të dhënave dhe do të sigurojë që vendimet për investime, disbursimet, progresi fizik dhe rezultatet të monitorohen dhe të raportohen si pjesë e sistemit të monitorimit dhe raportimit të Projektit.

Termat e referencës të detajuara për këtë pozicion mund të gjenden në faqen e mëposhtme:  
<https://mjedisi.gov.al/category/njofitime/>

Ministria e Mjedisit fton konsulentët individualë të kualifikuar të shprehin interesin e tyre për ofrimin e shërbimeve. Konsulentët e interesuar duhet të sigurojnë informacion që tregon se kanë kualifikimet e kërkuara dhe përvojën përkatëse për të kryer shërbimet.

Kriteret e kualifikimit janë:

***Arsimi:***

- Diplomë master ose kualifikim ekuivalent në ekonomi, inxhinieri mjedisore, administrim biznesi, drejtësi ose një fushë të ngjashme;
- Trajnim i specializuar i provueshëm në menaxhimin e kontratave, prokurim dhe monitorim/zbatim projektesh përbën avantazh.

***Eksperienca:***

- Të paktën 7 vjet përvojë pune në administrimin e granteve ose kontratave dhe monitorimin e performancës dhe/ose zbatimin e projekteve të financuara nga fonde publike ose donatorë;
- Përvojë në koordinimin me shumë palë institucionale (organe të administratës qendrore, njësi

zbatimi, konsulentë, verifikues të jashtëm etj.) për të siguruar realizimin në kohë të aktiviteteve të Projektit;

- Përvojë në përgatitjen, mirëmbajtjen dhe raportimin e evidencave të strukturuar administrative (instrumente ndjekjeje, regjistra, dosje të përputhshmërisë, dokumentacion auditimi) për organet drejtuese/mbikëqyrëse;

- Njohuri me operacionet e financuara nga Banka Botërore (përfshirë kërkesat për monitorim kontratash, raportim, përputhshmëri dhe dokumentacion) ose me procedurat e institucioneve të tjera të ngjashme financiare ndërkombëtare, konsiderohen një avantazh i rëndësishëm.

***Kompetencat:***

- Aftësi të forta në hartimin dhe mirëmbajtjen e planeve të monitorimit të kontratave (afatet, produktet/dorëzimet, raportet, kushtet e pagesave) dhe në përgatitjen e përmbledhjeve të qarta menaxheriale dhe përditësimeve të statusit;

- Aftësi të shkëlqyera koordinimi, komunikimi dhe negocimi me institucione, konsulentë dhe ofrues shërbimesh, përfshirë aftësinë për të ndjekur detyrimet e nevojshme dhe për të zgjidhur çështjet e zbatimit;

- Njohuri të plota dhe të avancuara pune në gjuhën angleze;

- Njohuri të plota të gjuhës shqipe (nivel folësi amtar);

- Aftësi shumë të mira kompjuterike, veçanërisht zotërim i plotë i paketës *Microsoft Office*;

- Aftësi për të punuar në një ambient shumëkombësh dhe multikulturor, si dhe stil pune proaktiv;

- Niveli i lartë i integritetit, përpikërisë dhe respektimit të procedurave të brendshme dhe legjislacionit kombëtar në fuqi;

- Njohuri me politikat dhe procedurat e administratës shtetërore.

Vëmendja e Konsulentëve të interesuar tërhiqet te seksioni III, paragrafët 3.13, 3.15 dhe 3.16 të “Rregulloreve të Prokurimit për Huamarrësit e IPF-së” të Bankës Botërore, të shtatorit 2025 (“Rregulloret e Prokurimit”), ku përcaktohet politika e Bankës Botërore mbi konfliktin e interesit.

Konsulenti do të zgjidhet në përputhje me metodën e përzgjedhjes së konsulentit individual të përcaktuar në Rregulloret e Prokurimit.

Informacione të mëtejshme mund të merren në adresën e mëposhtme gjatë orarit të punës nga 08:00 deri në 16:30, nga e hëna në të enjte, dhe nga ora 08:00 deri në 14:00, të premten.

Shprehjet e interesit duhet të dorëzohen në formë të shkruar në adresën e mëposhtme (personalisht, ose me postë, ose me *e-mail*) deri më **25 nëntor 2025, ora 16:30**.

**Ministria e Mjedisit**

Mjedis i Pastër dhe me Aftësi Ripërtëritëse për Detin Blu (Care4BlueSea)

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 1

1001 Tiranë, Shqipëri

Për: Znj. Ledina Beqiraj Agalliu

Sekretare e Përgjithshme

E-mail: [ledina.beqiraj@mjedisi.gov.al](mailto:ledina.beqiraj@mjedisi.gov.al)

Për: Znj. Artenida Duraku

E-mail: [artenida.duraku@mjedisi.gov.al](mailto:artenida.duraku@mjedisi.gov.al)

**TERMAT E REFERENCËS**  
**PËRZGJEDHJA E MENAXHERIT TË INVESTIMEVE PËR PMT-në**  
**“MJEDIS I PASTËR DHE ME AFTËSI RIPËRTËRITËSE PËR DETIN BLU”**

**1. SFONDI**

Ministria e Mjedisit (MoE) po zbaton Projektin “Mjedis i pastër dhe me aftësi ripërtëritëse për detin blu” (Care4BlueSea), një operacion investimi i konceptuar për të ulur ndotjen nga burimet tokësore në mjedisin ujor në zona të përzgjedhura të brezit bregdetar jug-perëndimor të Shqipërisë. Projekti ka hyrë në fuqi më 31 mars 2025 dhe përfundon më 29 mars 2030. Projekti përbëhet nga tre komponentë:

*Komponenti 1: Promovimi i qasjeve të integruara dhe qarkulluese për mbrojtjen e peizazheve dhe burimeve ujore në Zonën e Mbetjeve Gjirokastrë-Vlorë Jug.*

*Komponenti 2: Ujla e ndotjes së ujit në lumin Vjosë përmes ndërhyrjeve të synuara në ujërat e ndotura komunale dhe ujërat e shiut, me theks te rritja e qëndrueshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike.*

*Komponenti 3: Menaxhimi i veprimtarive të Projektit, duke përfshirë menaxhimin e Projektit, monitorimin dhe vlerësimin, që mbulon menaxhimin financiar, prokurimin, menaxhimin e rreziqeve mjedisore dhe sociale, auditimet e Projektit dhe trajnimin e ekipeve përkatëse.*

Parashikohet që Projekti të ketë dy agjenci zbatuese (AZ). Ekipi i Menaxhimit të Projektit (PMT) pranë MoE-së ka rol të dyfishtë: mbikëqyrjen e koordinimit të përgjithshëm të Projektit dhe zbatimin e komponentëve të MoE-së të përcaktuara në Manualin e Operimeve të Projektit (POM). Paralelisht, AKUK-ja do të krijojë një Njësi të Koordinimit të Projektit (PCU) për të menaxhuar Programin “Program-for-Results” të financuar nga Banka Botërore për Programin e Modernizimit të Sektorit Kombëtar të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve. PCU-ja merr përsipër zbatimin e përditshëm të pjesëve të AKUK-ut, në përputhje me POM-in, ndërkohë që MoE ruan rolin e koordinimit të përgjithshëm.

**2. QËLLIMI I DETYRËS**

Qëllimi i kësaj detyre për Menaxherin e investimeve është të mbështesë Ministrinë e Mjedisit, përmes Ekipit të Menaxhimit të Projektit, në zbatimin operativ nga fillimi në fund, koordinimin dhe mbikëqyrjen e të gjitha veprimtarive të lidhura me investimet dhe performancën, të financuara në kuadër të komponentit 1: “Qasje të integruara dhe qarkulluese për mbrojtjen e peizazheve dhe burimeve të ujit”. Komponenti 1 përfshin: i. forcimin e mjedisit institucional, financiar dhe rregullator për menaxhimin e mbetjeve të ngurta urbane dhe qarkullueshmërinë (nënkomponenti 1.1); ii. financimin dhe administrimin e skemës së Investimeve të Bazuara në Performancën Mjedisore (EPBI) për bashkitë pjesëmarrëse në Zonën e Mbetjeve Vlorë Jug–Gjirokastrë (nënkomponenti 1.2); dhe iii. menaxhimin e njohurive, rritjen e ndërgjegjësimit, ndryshimin e sjelljes dhe masat e synuara të infrastrukturës/mbështetjes për ndarjen në burim të mbetjeve, riciklimin dhe rritjen e pranueshmërisë së shërbimit, duke përfshirë veprimet prioritare në zonat me presion të lartë të popullsisë dhe turizmit (nënkomponenti 1.3).

Konsulenti do të krijojë dhe do të vërë në funksion programin EPBI për menaxhimin e mbetjeve të ngurta urbane, duke siguruar që bashkitë të përfitojnë investime vendore të lidhura me performancën, bazuar në përmirësime të matshme dhe të qëndrueshme në ofrimin e shërbimit (si p.sh.: mbulimi i grumbullimit të mbetjeve, rikuperimi i kostove, riciklueshmëria dhe mbulimi i shërbimit), në përputhje me rregullat e pranueshmërisë, kushtet minimale të aksesit (MACs), treguesit kryesorë të performancës (KPIs), kërkesat e verifikimit, formulën e alokimit dhe ciklin vjetor të përcaktuar në POM dhe manualin EPBI.

Ministria e Mjedisit do të lançojë një program të investimeve mjedisore të bazuara në performancë në fushën e menaxhimit të mbetjeve të ngurta urbane (MSWM EPBI) në Zonën e Mbetjeve Vlorë Jug–Gjirokastrë, me synim përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve bashkiake. Bashkitë do të përfitojnë investime vendore kundrejt përmirësimeve të matshme dhe të qëndrueshme në grumbullimin e

mbetjeve të ngurta, rritjen e riciklueshmërisë dhe/ose rikuperimin e kostove. Këto investime vendore do të nxisin ndryshimin e sjelljes për hapësira urbane më të pastra dhe më të gjelbra, si dhe për ekosisteme bregdetare dhe ujore më të shëndetshme. Bashkitë do të kualifikohen për t'u përfshirë në skemën EPBI në bazë të performancës së tyre të mëparshme, përveç kritereve të tjera.

Për të siguruar mjedisin e përshtatshëm mundësues që u nevojitet bashkive për të arritur përmirësime në performancë përmes EPBI-së, Projekti do të mbështesë një sërë investimesh paraprake gjatë dy vjetëve të parë të zbatimit. Këto investime do të konsistojnë në pajisje për të mbështetur sistemin e monitorimit të bashkive; furnizimin me pajisje dhe automjete për grumbullimin e mbetjeve dhe ndarjen në burim; si dhe pajisje për qendra riciklimi.

Konsulenti pritet të asistojë Ministrinë e Mjedisit në krijimin e skemës EPBI për mbetjet e ngurta dhe një kuadër të fortë për menaxhimin efektiv të tyre, të përafruar me standardet e Bankës Botërore. Roli i tij/saj është thelbësor për të garantuar një zbatim në kohë dhe me cilësi të lartë të proceseve të menaxhimit të programit, raportimit dhe investimeve. Qëllimi është të sigurohet transparenca, llogaridhënia dhe përparimi efikas financiar dhe teknik, duke kontribuar në fund në zbatimin me sukses të programit të propozuar.

### **3. FUSHA E PUNËS**

Menaxheri i investimeve do të punojë me kohë të plotë nën drejtimin e koordinatorit të PMT-së brenda Ministrisë së Mjedisit dhe do të koordinohet ngushtësisht me ekspertët e tjerë të PMT-së (prokurimi, menaxhimi financiar, monitorimi dhe vlerësimi, mjedisi dhe çështjet sociale), me bashkitë në Zonën e Mbetjeve Vlorë Jug–Gjirokastrë, si dhe me çdo konsulent/kontraktor të jashtëm të angazhuar në kuadër të komponentit 1.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Menaxherit të investimeve do të përfshijnë sa vijon:

#### **A. Administrimi i skemës së investimeve mjedisore të bazuara në performancë (EPBI)**

- Të vërë në funksion dhe të mirëmbajë mekanizmin EPBI, duke përfshirë rregullat, kriteret e pranueshmërisë (kushtet minimale të aksesit), treguesit kryesorë të performancës (KPIs), metodologjinë e vlerësimit të performancës, formulën e alokimit, afatet kohore dhe kërkesat për raportim, siç përcaktohen në POM dhe manualin EPBI.

- Të përgatisë dhe përditësojë çdo vit udhëzuesit e performancës së EPBI-së për bashkitë, duke përfshirë objektivat e performancës dhe provat/dokumentacionin mbështetës të kërkuar, afatet dhe formatet e raportimit, përshkrimin e formulës së alokimit dhe mënyrën se si do të llogariten grantet/shpërblymjet, si dhe përshkrimin e hapave të verifikimit dhe ankimit.

- Të sigurojë që të gjithë hapat e ciklit EPBI të jenë të gjurmueshëm dhe të dokumentuar për nevoja auditimi, rishikimi nga Banka Botërore dhe kontrolli i brendshëm.

#### **B. Koordinimi me bashkitë, grumbullimi i të dhënave, pajisja me kërkesat dhe verifikimi**

- Të veprojë si pika kryesore e kontaktit të PMT-së për të gjitha bashkitë pjesëmarrëse në komponentin 1 (bashkitë e Zonës së Mbetjeve Vlorë Jug–Gjirokastrë dhe përfitues të tjerë të pranueshëm).

- Të komunikojë me çdo bashki kërkesat e pranueshmërisë, pritshmëritë e performancës, kërkesat për dokumentacionin dhe afatet kohore.

- Të kërkojë, të marrë dhe të organizojë gjithë provat/dokumentacionin e paraqitur nga bashkitë (p.sh. mbulimin e shërbimit të mbetjeve, të dhëna mbi arkëtimin e tarifave/rikuperimin e kostove, alokimet buxhetore për shërbimet e menaxhimit të mbetjeve të ngurta urbane (MSWM), funksionimin e sistemeve të grumbullimit/transferimit/ndarjes).

- Të mirëmbajë një sistem të strukturuar ndjekjeje (regjistër) për paraqitjet e bashkive, afatet, kontrollet e plotësisë dhe veprimet pasuese.

- Të identifikojë mungesat, mospërputhjet ose informacionin që mungon dhe të koordinojë me bashkitë për zgjidhjen e tyre përpara verifikimit të pavarur.

- Të lehtësojë, të regjistrojë dhe të ndjekë çdo ankim ose kërkesë sqarimi të paraqitur nga bashkitë në lidhje me vlerësimin e performancës ose vendimin e alokimit.

- Të koordinojë me të gjithë palët e interesuara të EPBI-së për menaxhimin e Projektit dhe raportimin. Të monitorojë në mënyrë aktive rreziqet e programit, të zbatojë masat e zbutjes dhe të mbikëqyrë proceset e ankimit nga bashkitë.

- Të mbështesë ekspertin e prokurimit të PMT-së në prokurimin, kontraktimin dhe menaxhimin e këtij verifikuesi, në përputhje me rregulloret e prokurimit të Bankës Botërore dhe kërkesat kombëtare.

- Të koordinojë programin e punës së verifikuesit të pavarur, duke përfshirë vënien në dispozicion të të dhënave bashkiake, planifikimin e vizitave në terren dhe aksesin te zyrtarët vendorë dhe infrastruktura.

- Të rishikojë gjetjet paraprake të verifikuesit për plotësinë, koherencën metodologjike dhe saktësinë, përpara se ato të finalizohen.

- Të sigurojë që të gjitha rezultatet e verifikimit të mbështeten në prova të dokumentuara dhe të mund të përdoren për të justifikuar alokimet dhe vendimmarrjen e prokurimit.

### **C. Rekomandimi për alokimin, raportimi dhe publikimi i informacionit**

- Të përgatisë raportin vjetor të monitorimit mbi performancën bashkiake në kuadër të skemës EPBI, duke konsoliduar:

- rezultatet e verifikuara të performancës për çdo bashki;

- konfirmimin e pranueshmërisë/pajtuashmërisë me kushtet minimale të aksesit;

- alokimin e rekomanduar të investimeve të bazuara në performancë për secilën bashki për ciklin pasardhës.

- Të paraqesë draftraportin për rishikim te koordinatori i PMT-së dhe drejtuesit e Ministrisë së Mjedisit, dhe ta rishikojë sipas nevojës.

- Të përgatisë një shënim të qartë të rekomandimit për alokimin, ku të shpjegohet mënyra se si është zbatuar formula dhe të justifikohen çdo faktor barazie/rregullimi.

- Të mbështesë Ministrinë e Mjedisit në formalizimin dhe publikimin zyrtar të vendimeve të alokimit, për të siguruar transparencë dhe llogaridhënie.

- Të mirëmbajë një dosje të auditueshme për të gjitha vendimet, të dhënat hyrëse, arsyetimet dhe miratimet.

### **D. Paketa e investimeve, mbështetja në prokurim dhe transferimi i aktiveve**

- Të punojë drejtpërdrejt me bashkitë për përzgjedhjen dhe përfitimin e investimeve të shpërblyera të parashikuara në programin EPBI.

- Të përkthejë alokimet e përzgjedhura dhe të miratuara për bashkitë në paketa konkrete investimi (mallra, pajisje, punime të vogla, shërbime), në përputhje me shpenzimet e pranueshme nën komponentin 1.

- Të përgatisë hyrjet teknike (përshkrimet, specifikimet teknike, sasitë e kërkuara, vendndodhjet e shpërndarjes, afatet kohore) për secilën paketë, për t'u integruar në planin e prokurimit të PMT-së.

- Të punojë ngushtësisht me ekspertin e prokurimit të PMT-së për:

- planifikimin në kohë dhe grupimin (*bundling*) e tenderave;

- mbështetjen gjatë vlerësimit të ofertave/propozimeve kur paketat e investimit lidhen drejtpërdrejt me alokimet bashkiake;

- ndjekjen e administrimit të kontratave për sigurimin e dorëzimeve në kohë.

- Të koordinojë me ekspertin e menaxhimit financiar të PMT-së për buxhetimin, planifikimin e disburseimeve, raportimin financiar dhe përputhshmërinë e investimeve me kategoritë e financimit të pranueshme të Projektit.

- Të organizojë dhe dokumentojë dorëzimin fizik të mallrave/pajisjeve të prokuruar për çdo bashki përfituese, duke përfshirë fletëdorëzimet, aktet e pranimit, fotot, numrat serialë (kur është e aplikueshme) dhe çdo kusht të rënë dakord për përdorimin.

- Të mirëmbajë dhe të përditësojë periodikisht një Regjistër të Transferimit të Aktiveve, ku të pasqyrohen të gjitha asetet e financuara nga EPBI-ja që u janë vënë në dispozicion bashkive, si dhe të ndjekë përdorimin dhe gjendjen e tyre.

- Të kryejë çdo detyrë tjetër që i caktohet nga koordinatori i PMT-së.

### **E. Prania në terren, koordinimi në vende dhe ndjekja e zbatimit**

Të kryejë vizita periodike në bashkitë e Zonës së Mbetjeve Vlorë Jug–Gjirokastrë dhe në vendndodhje të tjera të synuara në kuadër të Komponentit 1, me qëllim që:

- të ndjekë ecurinë e zbatimit të investimeve të financuara nga EPBI-ja;
- të konfirmojë dorëzimin, instalimin dhe vënien në funksion të aseteve të prokuruar;
- të vëzhgojë në terren performancën e shërbimit (sistemet e grumbullimit, pikat e ndarjes, operationet e transferimit/ndarjes, pastërtinë në zonat prioritare etj.);
- të identifikojë pengesat operationale që mund të ndikojnë te treguesit e performancës.

Gjatë misionëve në terren, të zhvillojë takime koordinimi me:

- drejtuesit e bashkive dhe stafin teknik (drejtoritë e menaxhimit të mbetjeve/shërbimeve publike, drejtoritë e financës);
- strukturat rajonale dhe lokale përgjegjëse për monitorimin dhe zbatimin (*enforcement*);
- konsulentët/kontraktorët e financiar në kuadër të nënkomponentëve 1.1, 1.2 dhe 1.3.
- Të informojë menjëherë koordinatorin e PMT-së për çdo vonesë serioze, mospërputhje ose rrezik (teknik, fiduciar, mjedisor/social, reputacional), duke propozuar masa zbutëse ose veprime korrigjuese.
- Të ndjekë me bashkitë zbatimin e veprimeve të rëna dakord si korrigjuese dhe të verifikojë mbylljen e tyre gjatë vizitave pasuese.
- Të koordinojë me ekspertin mjedisor dhe social (E&S) të PMT-së për të siguruar që të gjitha investimet në kuadër të komponentit 1 të jenë në përputhje me kërkesat përkatëse mjedisore dhe sociale (përfshirë ESMP-të specifike për vendndodhjen ose instrumente të tjera), si dhe që çdo ankesë ose shqetësim që lidhet me performancën bashkiake, ofrimin e shërbimit ose rezultatet e alokimit të regjistrohet dhe të trajtohet në mënyrë të përshtatshme përmes mekanizmit të ankesave të Projektit.
- Të koordinojë me ekspertin e monitorimit dhe vlerësimit (M&V) të PMT-së për të siguruar që performanca e verifikuar e bashkive dhe vëzhgimet në terren të pasqyrohen në kornizën e rezultateve të Projektit dhe në raportet gjashtë mujore drejtuar Bankës Botërore.

#### **4. PRODUKTET E PRITSHME**

Konsulenti do të dorëzojë raporte tremujore dhe vjetore të progresit, duke theksuar ndjekjen e fushës së tij/saj të punës

#### **5. RAPORTIMI**

Konsulenti do të punojë si pjesë e PMT-së. Ai/ajo do t'i raportojë dhe do të punojë nën drejtimin e koordinatorit të PMT-së. Konsulenti do të punojë në bashkëpunim të ngushtë me bashkitë dhe palët e tjera të interesuara, për të siguruar që Projekti të menaxhohet në mënyrë efikase dhe në përputhje me objektivat e dokumentit të vlerësimit të Projektit (PAD), marrëveshjes së Huas, manualit operational të Projektit (POM) dhe manualit të investimeve mjedisore të BAZUARA NË PERFORMANCË (EPBI).

#### **6. KUALIFIKIME DHE PËRVOJA**

##### *Arsimi*

- Diplomë master ose kualifikim ekuivalent në ekonomi, inxhinieri mjedisore, administrim biznesi, drejtësi ose një fushë të ngjashme.

- Trajnim i specializuar i provueshëm në menaxhimin e kontratave, prokurim dhe monitorim/zbatim projektsh përbën avantazh.

##### *Eksperienca*

- Të paktën 7 vjet përvojë pune në administrimin e granteve ose kontratave dhe monitorimin e performancës dhe/ose zbatimin e projekteve të financuara nga fonde publike ose donatorë.

- Përvojë në koordinimin me shumë palë institucionale (organe të administratës qendrore, njësi zbatimi, konsulentë, verifikues të jashtëm etj.) për të siguruar realizimin në kohë të aktiviteteve të Projektit.

- Përvojë në përgatitjen, mirëmbajtjen dhe raportimin e evidencave të strukturuar administrative (instrumente ndjekjeje, regjistra, dosje të përputhshmërisë, dokumentacion auditimi) për organet drejtuese/mbikëqyrëse.

- Njohuri me operacionet e financuara nga Banka Botërore (përfshirë kërkesat për monitorim kontratash, raportim, përputhshmëri dhe dokumentacion) ose me procedurat e institucioneve të tjera të ngjashme financiare ndërkombëtare, konsiderohen një avantazh i rëndësishëm.

#### *Kompetencat*

- Aftësi të forta në hartimin dhe mirëmbajtjen e planeve të monitorimit të kontratave (afatet, produktet/dorëzimet, raportet, kushtet e pagesave) dhe në përgatitjen e përmbledhjeve të qarta menaxheriale dhe përditësimeve të statusit.

- Aftësi të shkëlqyera koordinimi, komunikimi dhe negocimi me institucione, konsulentë dhe ofrues shërbimesh, përfshirë aftësinë për të ndjekur detyrimet e nevojshme dhe për të zgjidhur çështjet e zbatimit.

- Njohuri të plota dhe të avancuara pune në gjuhën angleze.

- Njohuri të plota të gjuhës shqipe (nivel folësi amtar).

- Aftësi shumë të mira kompjuterike, veçanërisht zotërim i plotë i paketës *Microsoft Office*.

- Aftësi për të punuar në një ambient shumëkombësh dhe multikulturor, si dhe stil pune proaktiv.

- Niveli i lartë i integritetit, përpikërisë dhe respektimit të procedurave të brendshme dhe legjislacionit kombëtar në fuqi.

- Njohuri me politikat dhe procedurat e administratës shtetërore.

#### **7. KRITERET E VLERËSIMIT**

Kandidatët që plotësojnë kërkesat e kualifikimit do të vlerësohen më tej bazuar në kriteret e mëposhtme:

- Kualifikimet e përgjithshme – 30 pikë;

- Përshtatshmëria me detyrën – 60 pikë;

- Gjuha – 10 pikë.

#### **8. PËRZGJEDHJA**

Shërbimi do të përzgjidhet në përputhje me dispozitat e “Rregulloreve të Prokurimit të Bankës Botërore për Huamarrësit në kuadër të financimit të Projekteve të investimit (IPF)”, datë 1 korrik 2016, të rishikuara në nëntor 2017, gusht 2018, nëntor 2020 dhe shtator 2023, bazuar në metodën e përzgjedhjes së konsulentëve individualë. Konsulentit do t’i ofrohen mundësi për zhvillim profesional përmes pjesëmarrjes në aktivitete dhe kurse trajnimi të rëndësishme gjatë periudhës së angazhimit.

Kohëzgjatja: Menaxheri i investimeve do të angazhohet me kohë të plotë dhe kohëzgjatja e kontratës fillimisht do të jetë një vit, me mundësi shtyrjeje deri në 4,5 vjet, në varësi të performancës së kënaqshme të konsulentit.

Vendndodhja: Eksperti, Menaxher i investimeve do të jetë i caktuar të punojë në zyrat e PMT-së për Projektin Care4BlueSea, në Tiranë, Shqipëri.

### **REQUEST FOR EXPRESSIONS OF INTEREST CONSULTING SERVICES – INDIVIDUAL CONSULTANTS**

Country: **ALBANIA**

Name of the Project: **Clean and Resilient Environment for Blue Sea (Care4BlueSea)**

Loan No.: **95070-AL**

Project ID Number: **P176163**

Assignment Title: **Selection of the Investment Manager for the PMT**

Reference No.: **AL-MTE-520636-CS-INDV**

The Government of Albania has received financing from the World Bank toward the cost of the Clean and Resilient Environment for Blue Sea Project and intends to apply part of the proceeds for consulting services.

The consulting services (“the Services”) include selection of an Investment Manager for the PMT

at the Ministry of Environment (MoE). The PMT Investment Manager will support MoE/PMT in the overall planning, coordination, implementation and monitoring of all performance-based investments financed under Component 1, including the establishment and operationalization of the Environmental Performance-Based Investment (EPBI) program in the Vlora South–Gjirokastrë Waste Zone. He/She will work as part of the PMT, report to and work under the direction of the PMT Coordinator, participating municipalities and other relevant stakeholders to ensure that the EPBI cycle, the allocation of funds and related investments are prepared, implemented and documented in a timely manner and in full compliance with the Project Appraisal Document (PAD), Loan Agreement, Project Operational Manual (POM), EPBI Manual, World Bank requirements and applicable national legislation. The Investment Manager will act as focal point for municipalities on all EPBI-related operational and investment matters, coordinate data collection and verification processes, and ensure that investment decisions, disbursements, physical progress and results are adequately tracked and reported as part of the project’s monitoring and reporting system.

The detailed Terms of Reference (TOR) for the assignment *can be found at the following website:*  
<https://mjedisi.gov.al/category/njoftime/>

The Ministry of Environment now invites eligible individual consultants (“Consultants”) to indicate their interest in providing the Services. Interested Consultants should provide information demonstrating that they have the required qualifications and relevant experience to perform the Services. The qualification criteria are:

***Education:***

- A Master’s degree or equivalent qualification in economics, environmental engineering, business administration, law or related field.
- Proven specialized training in contract management, procurement, and project monitoring/implementation is an asset.

***Experience:***

- At least 7 years’ working experience in the grant or contract administration and performance monitoring and/or implementation of publicly funded or donor-funded projects.
- Experience coordinating with multiple institutional stakeholders (central government bodies, implementation units, consultants, external verifiers, etc.) to ensure timely delivery of project activities.
- Experience preparing, maintaining, and reporting structured administrative records (tracking tools, registers, compliance files, audit documentation) to management/oversight bodies.
- Familiarity with World Bank–financed operations (including requirements for contract monitoring, reporting, compliance, and documentation) or with procedures of similar international financial institutions is considered a strong asset.

***Competences:***

- Strong skills in developing and maintaining contract monitoring plans (deadlines, deliverables, reports, payment triggers) and producing clear management briefs and status updates.
- Excellent coordination, communication, and negotiation skills with institutions, consultants, and service providers, including the ability to follow up on required actions and resolve implementation issues.
- Full, high-level working proficiency in English.
- Fully proficient in the Albanian language (native speaker level).
- Excellent computer skills in particular full proficiency in Microsoft Office.
- Ability to work in a multinational, multicultural environment, and proactive working style.

- High sense of integrity, diligence, and compliance with internal procedures and applicable national regulations.

- Familiarity with public administration policies and procedures.

The attention of interested Consultants is drawn to Section III, paragraphs, 3.13, 3.15, and 3.16 of the World Bank's "Procurement Regulations for IPF Borrowers" September 2025 ("Procurement Regulations"), setting forth the World Bank's policy on conflict of interest.

A Consultant will be selected in accordance with the Individual Consultant Selection method set out in the Procurement Regulations.

Further information can be obtained at the address below during office hours 08.00 to 16.30 from Monday to Thursday and 08.00 to 14.00 on Friday.

Expressions of interest must be delivered in a written form to the address below (in person, or by mail, or by fax, or by e-mail) by **November 25<sup>th</sup>, 2025, 16:30 local time**.

For more information interested consultants can find the Terms of References attached.

### **Ministry of Environment**

Clean and Resilient Environment for Blue Sea

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 1

1001 Tiranë, Shqipëri

Attn: Mrs. Ledina Beqiraj Agalliu

Secretary General

E-mail: [ledina.beqiraj@mjedisi.gov.al](mailto:ledina.beqiraj@mjedisi.gov.al)

Attn: Mrs. Artenida Duraku

E-mail: [artenida.duraku@mjedisi.gov.al](mailto:artenida.duraku@mjedisi.gov.al)

## **TERMS OF REFERENCE**

### **SELECTION OF INVESTMENT MANAGER FOR PMT**

#### **CLEAN AND RESILIENT ENVIRONMENT FOR BLUE SEA - ALBANIA**

##### **1. BACKGROUND**

The Ministry of Environment (MoE) is implementing the Clean and Resilient Environment for Blue Sea Project (CARE4BlueSea), an investment operation designed to reduce pollution from land-based sources into the aquatic environment in selected areas of Albania's South-West Coastal Belt. The Project became effective on March 31, 2025, and is finalized on March 29, 2030. The project comprises three components:

*Component 1:* Promoting integrated and circular approaches for protecting landscapes and water resources in the Vlora South-Gjirokaster Waste Zone.

*Component 2:* Reducing water pollution in the Vjosa River through targeted interventions in municipal wastewater and stormwater, emphasizing climate resilience.

*Component 3:* Managing project activities, including project management, monitoring, and evaluation, covering financial management, procurement, environmental and social risk management, project audits, and training for relevant teams.

*The project is envisioned to have two Implementing Agencies (IAs).* The Project Management Team (PMT) at MoE plays a dual role: overseeing overall project coordination and implementing MoE's components outlined in the Project Operations Manual (POM). Simultaneously, AKUK will establish a Project

Coordination Unit (PCU) to manage the World Bank-funded Program-for-Results on National Water Supply and Sanitation Sector Modernization Program. The PCU takes charge of daily implementation of AKUK's parts, following the POM, while MoE maintains the overall coordination.

## 2. OBJECTIVE OF THE ASSIGNMENT

The objective of the Investment Manager assignment is to support the MoE, through the Project Management Team, **in the end-to-end operational implementation, coordination, and oversight of all investment- and performance-related activities financed under Component 1:** “Integrated and Circular Approaches for Protection of Landscapes and Water Resources.” Component 1 includes (i) strengthening the institutional, financial, and regulatory environment for municipal solid waste management and circularity (Subcomponent 1.1); (ii) financing and administering the Environmental Performance-Based Investments (EPBI) scheme for participating municipalities in the Vlorë South–Gjirokastrë Waste Zone (Subcomponent 1.2); and (iii) knowledge management, awareness-raising, behavior change and targeted infrastructure/support measures for waste separation, recycling, and service acceptance, including priority actions in areas of high population and tourism pressure (Subcomponent 1.3).

The consultant will Establish and operationalize the EPBI program for municipal solid waste management, ensuring that municipalities receive performance-linked local investments based on measurable and sustained improvements in service delivery (such as waste collection coverage, cost recovery, recyclability, and service coverage), in line with the eligibility rules, Minimum Access Conditions (MACs), Key Performance Indicators (KPIs), verification requirements, allocation formula, and annual cycle defined in the POM and the EPBI Manual.

The MoE will launch a MSWM Environmental Performance Based Investment program in the Vlorë South-Gjirokastrë Waste Zone for improved municipal waste management. Municipalities will receive local investment upon measurable and sustained improvements on solid waste collection, increased recyclability and/or cost recovery. These local investments will support behavior change for cleaner and greener urban space and healthier coastal and aquatic ecosystems. Municipalities will become eligible to enter the EPBI based on past performance in addition to other criteria.

To ensure the appropriate enabling environment for municipalities to achieve performance improvements through EPBI, the project will support a set of upfront investments during the first two years of project implementation. These investments would consist of equipment to support the monitoring system of municipalities; provision of equipment and vehicles for waste collection and source separation; and provision of equipment for recycling centers.

The Consultant is expected to assist the MoE to establish EPBI for solid waste and a robust framework for their effective management, aligned with World Bank standards. His / her role is crucial in ensuring timely and high-quality execution of program management, reporting, and investment processes. The goal is to ensure transparency, accountability, and efficient financial and technical progress, ultimately contributing to the successful implementation of proposed program.

## 3. SCOPE OF WORK

The Investment Manager will work full-time under the direction of the PMT Coordinator within the Ministry of Tourism and Environment (MoTE) and will coordinate closely with other PMT experts (procurement, financial management, M&E, environmental and social), the municipalities in the Vlorë South–Gjirokastrë Waste Zone, and any external consultants/contractors engaged under Component 1.

The responsibilities of the Investment Manager will include the following:

### **A. Administration of the Environmental Performance-Based Investment (EPBI) Scheme**

- Operationalize and maintain the EPBI mechanism, including the rules, eligibility criteria (Minimum Access Conditions), KPIs, performance assessment methodology, allocation formula, timelines, and reporting requirements, as set out in the POM and EPBI Manual.

- Prepare and update, on an annual basis, the EPBI Performance Guidelines for municipalities, including performance targets and required evidence, reporting deadlines and format, description of

the allocation formula and how awards will be calculated, description of the verification and appeal steps.

- Ensure that all steps of the EPBI cycle are traceable and documented for audit, World Bank review, and internal control.

### **B. Municipal Coordination, Data Collection, Compliance and Verification**

- Act as the primary PMT focal point for all municipalities participating in Component 1 (Vlora South–Gjirokastrë Waste Zone municipalities and other eligible beneficiaries).

- Communicate eligibility requirements, performance expectations, documentation requirements, and timelines to each municipality.

- Request, receive, and organize all evidence submitted by municipalities (e.g. waste service coverage, fee collection/cost recovery information, budgeting allocations for MSWM services, operation of collection/transfer/sorting systems).

- Maintain a structured tracking system (registry) of municipal submissions, deadlines, completeness checks, and follow-up actions.

- Identify gaps, inconsistencies, or missing information and coordinate with municipalities to resolve them before independent verification.

- Facilitate, log, and follow up on any appeals or clarifications submitted by municipalities regarding their performance assessment or allocation decision.

- Coordinate with all relevant EPBI stakeholders to coordinate project management and reporting. Actively monitor program risks, implement mitigation measures, and oversee municipality appeal processes.

- Support the PMT Procurement Expert in procuring, contracting, and managing this verifier in line with World Bank Procurement Regulations and national requirements.

- Coordinate the independent verifier's work program, including provision of municipal data, site visit scheduling, and access to local officials and infrastructure.

- Review the verifier's draft findings for completeness, methodological consistency, and accuracy before they are finalized.

- Ensure that all verification results are backed by documented evidence and can be used to justify allocations and procurement decisions.

### **C. Allocation Recommendation, Reporting, and Disclosure**

- Prepare the Annual Monitoring Report on municipal performance under the EPBI scheme, consolidating:

- Verified performance results for each municipality,

- Confirmation of eligibility/compliance with Minimum Access Conditions,

- Recommended allocation of performance-based investments for each municipality for the following cycle.

- Submit the draft report for review to the PMT Coordinator and MoE leadership, and revise as required.

- Prepare a clear Allocation Recommendation Note, explaining how the formula was applied and justifying any equity/adjustment factors.

- Support MoE in formalizing and publicly disclosing allocation decisions to ensure transparency and accountability.

- Maintain an auditable file of all decisions, data inputs, justifications, and approvals.

### **D. Investment Packaging, Procurement Support, and Asset Transfer**

- Work directly with Municipalities to select and reap rewarded investments outlined in the EPBI program.

- Translate selected and approved municipal allocations into concrete investment packages (goods, equipment, minor works, services) consistent with eligible expenditures under Component 1.

- Prepare technical inputs (descriptions, technical specifications, required quantities, delivery locations, timelines) for each package to feed into the PMT procurement plan.

- Work closely with the PMT Procurement Expert on:
  - scheduling and bundling of tenders;
  - support during bid/proposal evaluation when investment packages are directly linked to municipal allocations;
  - contract administration follow-up for timely delivery;
- Coordinate with the PMT Financial Management Expert on budgeting, disbursement planning, financial reporting, and consistency of investments with the Project's eligible financing categories.
- Organize and document the physical handover of procured goods/equipment to each beneficiary municipality, including delivery notes, acceptance certificates, photos, serial numbers (where applicable), and any agreed conditions of use.
- Maintain and periodically update an Asset Transfer Register capturing all EPBI-funded assets provided to municipalities, and follow up on their use and condition.
- Undertake any other duties as assigned by the PMT Coordinator.

#### **E. Field Presence, On-Site Coordination and Follow-Up**

- Conduct periodic visits to the Vlora South–Gjirokastrë Waste Zone municipalities and other targeted localities under Component 1 to:
  - follow up on implementation progress of EPBI-funded investments,
  - confirm delivery, installation, and operational use of procured assets,
  - Observe service performance on the ground (collection systems, separation points, transfer/sorting operations, cleanliness of priority areas, etc.),
  - Identify operational obstacles that may affect performance indicators.
- During field missions, hold coordination meetings with:
  - municipal leadership and technical staff (waste management / public services directorates, finance directorates),
  - regional and local structures responsible for monitoring and enforcement,
- Consultants/contractors financed under Subcomponent 1.1, 1.2 and 1.3.
- Escalate any serious delays, non-compliance, or risks (technical, fiduciary, environmental/social, reputational) to the PMT Coordinator with proposed mitigation or corrective actions.
- Follow up with municipalities on agreed corrective actions and verify their closure in subsequent visits.
- Coordinate with the PMT Environmental & Social (E&S) Expert to ensure that all investments under Component 1 comply with applicable environmental and social requirements (including site-specific ESMPs or other instruments), and that any grievances or complaints related to municipal performance, service delivery, or allocation outcomes are properly recorded and addressed through the Project grievance redress mechanism.
- Coordinate with the PMT M&E Expert to ensure that verified municipal performance and field observations are captured in the Project's results framework and semi-annual reports to the World Bank.

#### **4. EXPECTED DELIVERABLES**

The consultant will deliver quarterly and annual progress reports, highlighting the follow up of his/her scope of work.

#### **5. REPORTING**

The Consultant will work as part of the PMT. He / She will report to and work under direction of the PMT Coordinator and will report to him/her. The Consultant will work in close cooperation with municipalities and other relevant stakeholders to ensure that the project is managed efficiently and in compliance with the objectives of the Project Appraisal Document (PAD), Loan Agreement and Project Operational Manual (POM) and Environmental Performance Based Investment (EPBI) Manual.

#### **6. QUALIFICATION & EXPERIENCE**

*Education:*

- A Master's degree or equivalent qualification in economics, environmental engineering, business administration, law or related field.

- Proven specialized training in contract management, procurement, and project monitoring/implementation is an asset;

*Experience:*

- At least 7 years' working experience in the grant or contract administration and performance monitoring and/or implementation of publicly funded or donor-funded projects.

- Experience coordinating with multiple institutional stakeholders (central government bodies, implementation units, consultants, external verifiers, etc.) to ensure timely delivery of project activities.

- Experience preparing, maintaining, and reporting structured administrative records (tracking tools, registers, compliance files, audit documentation) to management/oversight bodies.

- Familiarity with World Bank-financed operations (including requirements for contract monitoring, reporting, compliance, and documentation) or with procedures of similar international financial institutions is considered a strong asset.

*Competences:*

- Strong skills in developing and maintaining contract monitoring plans (deadlines, deliverables, reports, payment triggers) and producing clear management briefs and status updates.

- Excellent coordination, communication, and negotiation skills with institutions, consultants, and service providers, including the ability to follow up on required actions and resolve implementation issues.

- Full, high-level working proficiency in English.

- Fully proficient in the Albanian language (native speaker level).

- Excellent computer skills in particular full proficiency in Microsoft Office.

- Ability to work in a multinational, multicultural environment, and proactive working style.

- High sense of integrity, diligence, and compliance with internal procedures and applicable national regulations.

- Familiarity with Government of Albania policies and procedures.

## 7. EVALUATION CRITERIA

Applicants that fulfill the qualification requirements will be further evaluated based on the below criteria:

- General Qualification – 30 points

- Adequacy for the assignment – 60 points

- Language – 10 points

## 8. SELECTION

The service will be selected under the provisions of the World Bank Procurement Regulations for Borrowers under Investment Project Financing” dated July 1, 2016, revised on November 2017, August 2018, November 2020 and September 2023 based on the method of Selection of Individual. The Consultant will be offered opportunities to develop professionally by attending relevant training events and courses during the term of the assignment.

**Duration:** The Investment Manager will be engaged **with a full-time position** and the duration of the contract is initially for **one year** with the possibility of extension to 4,5 years, subject to the satisfactory performance of the consultant.

**Location:** The Investment Manager Expert will be assigned to work in the office of PMT for Care4BlueSea project, in Tirana, Albania.